

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.B., nga fshati ... ,Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor, nga neni 189 par.1 lidhur me nënpar.1.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar A.Ç-av. H.J. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.60/17, datë 05.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 25.02.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar A.Ç. av. H.J., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.60/17, datë 05.11.2018, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë me aktgjykimin P.nr.60/17, datë 05.11.2018, të akuzuarin R.B., e ka shpall fajtor për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 189 par.1 lidhur me nen par 1.1 të (KPRK)-së, dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve , në të cilën dënim i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 02.12.2016 e deri me datën 02.01.2017. Me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burg i shndërrohet në dënim me burg i shndërrohet në dënim me gjobë në shumën prej 1800 (njëmijetëqind) € , të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh , nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mundë të paguaj gjobën, atëherë gjykata do ta zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burg. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) € , si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20(njëzet) € dhe taksën në shumën prej 30 (tridhjetë) € , në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, krejt këtë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I dëmtuari A.Ç., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur përfaqësues i autorizuar i palës së dëmtuar A.Ç. av. H.J. , dhe atë për shkak të vendimit mbi lartësinë e dënimit, me

propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të rëndë.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.53/2019, datë 01.02.2019, ka propozuar që të aprohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të të dëmtuarit A.Ç.t av. H.J. , e ushtruar kundër aktgjykimit të në Pejë me aktgjykimin P.nr.60/2017, datë 05.11.2018, ashtu që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit për veprën e kryer penale ti shqiptohet një dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit për dënim, në ankesën e përfaqësuesit me autorizim të të dëmtuarit A.Ç. av. H.J. pretendohet se gjykata e shkallës së parë me marrjen e vendimit është dashur të merr parasysh rrethanat shumë rënduese se veprën penale e ka kryer me paramendim me dashje dhe në mënyrë dinake, se i akuzuari asnjëherë nuk ka kërkuar falje familjes dhe se ende nuk janë pajtuar dhe as nuk i ka interesuar për shëndetin e të dëmtuarit. I dëmtuari ende edhe sot është duke u trajtuar nëpër mjek, ka probleme të mëdha shëndetësore, si dhe nga ekspertiza shihet se ka lëndime të rënda trupore ndërsa i akuzuari ka edhe shumë vepra tjera penale që i ka kryer më parë. Andaj, i njëjti konsideron se me dënime të tilla nuk do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozita ligjore, për çka i propozon kësaj gjykate që të njëjtit t'i shqiptoj dënim me të rëndë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit të shtetit për një dënim me gjobë ose me burg efektiv, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 73 të KPRK, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me ç 'rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë për

parasysh faktin se i njëjti ka pasur sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, i njëjti e ka pranuar fajësinë dhe shpreh keqardhje për veprën që ka kryer, thellë është penduar dhe publikisht para gjykatës i kërkon falje të dëmtuarit dhe familjarëve të tij, i premtun gjykatës se nuk do të përsërisë veprimet e tilla, ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se sipas evidencës së gjykatës është i dënuar sipas lëndës P.nr. 433/15 dhe P.nr. 103/15 dhe të njëjtat janë të plotfuqishme.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesën e prokurorit të shtetit sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me i ashpër sikurse që pa të drejtë pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar me burgim e i zëvendësuar me gjobë ndaj akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do ta parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij, kjo gjykatë konsideron se vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.31/19, datë 25.02.2019

Zyrtar ligjor
Shaban Prekalla

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Biljan Rexhiq